



PORTOFOLI I STUDENTIT

Anketë mbi shpenzimet financiare dhe të ardhurat e studentëve në kryeqytet.

PËRMBAJTJE

1. SITUATA FINANCIARE E STUDENTËVE
2. METODOLOGJIA
3. KAMPIONIMI
4. AKOMODIMI DHE USHQIMI
5. TRANSPORTI
6. LITERATURA DHE MJETET MËSIMORE
7. VESHMBATHJA DHE ARGËTIMI
8. TË ARDHURAT E STUDENTËVE
9. SHPENZIMET MESATARE PËR 1 STUDENT
10. GJETJET KRYESORE
11. REKOMANDIME

Ky botim u realizua nga Qëndresa Qytetare në kuadër të projektit "Arsimi në Fokus", me mbështetjen financiare të Olof Palme Center. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

1. SITUATA FINANCIARE E STUDENTËVE

Studentët që vijojnë procesin mësimor në kryeqytet rezultojnë të jenë studentët me barrën më të lartë financiare për shkak të kostove të larta të jetesës, tregut imobiliar, mungesës së konvikteve dhe mundësive të pakta të mbështetjes studentore.

Qëndresa Qytetare analizoi shpenzimet financiare të studentëve në pesë universitete publike në kryeqytet për të kuptuar nevojat, natyrën e shpenzimeve dhe peshën që zë punësimi, mbështetja me bursë apo mbështetja nga familja e tyre për të studiuar në kryeqytet. Kjo analizë u realizua nëpërmjet një pyetësoi online dhe dy fokus grupeve me studentë që studiojnë në kryeqytet. Një element tjetër që zbulon analiza e shpenzimeve është mënyra se si shpërndahen të ardhurat e tyre dhe çfarë peshe zë akomodimi, ushqimi apo vetë procesi mësimor. Situata financiare nënkupton sasinë dhe burimin e të ardhurave, nevojat bazike dhe kostot e studentëve në kryeqytet.

2. METODOLOGJIA

Pyetësoi online kaloi në këto faza:


- 1 – 10 Dhjetor 2021 – Realizim i pyetësoit nëpërmjet përodrimit të programit Google form duke dhe mbështetur nëpërmjet facebook ads.
- Për të siguruar gjithëpërfshirje, shpërndarje të drejtë dhe plotësim vetëm nga studente, pyetësoi u kushtëzua të shfaqej në mënyrë rastësore vetëm për të rinjtë e moshave 18-24 vjeç në të gjitha fashat orare dhe në të gjithë territorin e qarkut Tiranë.
- U targetuan të rinj të cilët dedektohen nga rrjeti facebook si grup interesi të fjaleve kyçe “Universitet” “Student” “Arsim”, si edhe duke u shpërndarë manualisht në rrjetet e grupeve universitare.
- Testimi i pyetësoit u realizua me 20 studentë nga rrjeti i studentëve “Arsimi në Fokus” para nisjes zyrtare të anketimit.

Qëllimi i kësaj analizë është evidentimi i situatës financiare të studentëve dhe nevojave të tyre në raport me ndjekjen normale të studimeve. Në analizë do të përfshihen kostot e akomodimit, ushqimit, veshmbathjes, literaturës, argëtimit dhe shkollimit.

3. KAMPIONIMI

Në pyetësor morën pjesë 775 studentë nga 5 universitete publike në Tiranë, **Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Mjekësisë dhe Universiteti i Arteve.**

70% e të pyeturve ishin vajza dhe 30% ishin djem, ndërsa 80% e popullatës i përkasin nivelit bachelor dhe 20% nivelit master. Ndërkohë sa i përket akomodimit, 60% e studentëve të pyetur banojnë në shtëpi me qera në kryeqytet, 20% jetojnë në konvikt, ndërsa 20% e studentëve të pyetur jetojnë në shtëpinë e familjes së tyre në kryeqytet.



4. AKOMODIMI DHE USHQIMI


Përvec tarifës vjetore që studentët paguajnë ndaj universitetit, një peshë kryesore të shpenzimeve të tyre e zënë akomodimi dhe ushqimi në kryeqytet. Rreth 67.5% e studentëve shprehen se shpenzimet e tyre mujore variojnë nga 150 në 400 euro. Vetëm 17% e tyre deklarojnë se shpenzimet e tyre janë nga

100 deri në 150 euro, ndërsa një masë prej 15.5% u shprehën se shpenzojnë mbi 400 euro në muaj.


Sa i përket shpenzimeve për akomodimin, 57.8% e studentëve pohojnë se paguajnë 50 deri në 150 euro në muaj për qera banese, 18.2% deklarojnë se banojnë në familjen e tyre, ndërsa 24% janë shprehur se shpenzojnë 200 euro ose më shumë

për akomodimin në kryeqytet. Ndërkohë shumica e studentëve, 58.9% shpenzojnë 3 deri në 7 euro në ditë për t'u ushqyer, 25.8% shpenzojnë 7 euro ose më shumë në ditë, ndërsa 15.3% e studentëve shprehen se e përballojnë ushqimin ditor me 1 deri në 3 euro.

Sa janë shpenzimet tuaja mujore?



Sa shpenzoni për akomodimin në kryeqytet?



Sa para shpenzoni në ditë për ushqim?



STUDENTË QË STUDIOJNË NË KRYEQYTET JANË RRETH

78 500

56500 PUBLIK + 22000 PRIVAT

KAPACITETI AKOMODUES NË KONVIKTET E TIRANËS ËSHTË 5549 SHTRËTËR

7%



Një ndër premtimet në kuadër të Paktit për Universitetin ishte investimi në infrastrukturën arsimore si ndërtimi i kampusit 28000 m2 në Qytetin Studenti, Megjithëse ndërtimi i kampusit universitar është premtuar prej vitit 2019, ende nuk kemi numër të shtuar të shtretërve, bibliotekave apo shërbimeve të ofruara për studentët në Qytetin Studenti.

Më 19 qershor 2019 kryeministri Rama së bashku me Kryetarin e Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj deklaruan se do fillonin punimet për ndërtimin e Kampusit Universitar. Por megjithëse kanë kaluar dy vite e gjysëm nga ky zotim i qeverisë dhe pushtetit lokal ndërtimi i kampusit, sipas edhe një korrespondence të Faktoje më bashkinë Tiranë gjatë vitit 2021 është ende në faze tenderimi dhe gjenerimi fondesh për ndërtimin e objektit.

Ndërkohë Rezidenca Universitare Studentore nr. 2 që ka në administrim 8 godinat e mjekësisë dhe inxhinierisë për vitin akademik 2021 – 2022 ka në dispozicion të studentëve vetëm 50% të kapacitetit të saj, pra 930 shtretër në total. Katër godinat e tjera, sipas drejtorisë janë në rikonstruksion për shkak të tërmetit të 26 nëntorit 2019, pavarësisht se përfaqësuesit e qeverisë u shprehën se kampuset do të ndërtohen brenda vitit 2020.


Ndërkohë Qyteti Studenti, që është njësi më e madhe akomoduese në Tiranë për vitin akademik 2021 – 2022 strehon 4619 studentë, numër i njëjtë shtretërisht me atë të vitit 2020 – 2021. Pra nuk kemi asnjë shtim të numrit të shtretërve, por vetëm disa punime restauruese në 2 godina. Ndërkohë që konviktet e Universitetit Bujqësor të Tiranës janë rrëzuar në tokë për t'ju nënshtruar procesit të rindërtimit. Sipas premtimit të qeverisë, konviktet e reja të UBT do të strehojnë vetëm 2100 studentë, pra vetëm 1/3 e numrit total të studentëve që ka ky universitet.

Aktualisht në kryeqytet studiojnë rreth 56 500 studentë në universitetet publike dhe rreth 22 000 në ato private, ndërkohë që numri total i shtretërve të vëna në dispozicion nga konviktet është 5549 shtretër, pra konviktet në kryeqytet ofrojnë vetëm 7% kapacitetet akomoduese për studentët e universiteteve.

5. TRANSPORTI

Duke pasur parasysh shpërndarjen gjeografike të kryeqytetit, largësinë e godinave nga lagjet periferike të preferuara nga studentët për shkak të cmimeve më të ulëta të banesave, transporti publik është një mjet i domosdoshëm për pjesën dërrmuese të studentëve. 39.4% e studentëve deklarojnë se shpenzojnë 10 euro në muaj për transportin publik brenda Tiranës, shifër e cila përkon edhe me çmimin e abonësë së studentit. Ndërkohë 42.4% e studentëve shprehen se shpenzojnë 20 deri 30 euro në muaj për transportin, ndërkohë që 18.2% janë shprehur se nuk kanë shpenzime për transportin brenda Tiranës. Sa i përket kategorisë e cila shpenzon nga 20 deri në 30 euro në muaj, bëhet fjalë për ata studentë të cilët ndrojnë disa linja autobusi në ditë dhe nuk kanë arritur dot të përfitojnë abone student, për shkak të numrit të limituar të prodhimit të saj.

Ndërkohë kosto të larta për studentin janë edhe udhëtimet jashtë Tiranës, në drejtim të vendbanimeve të tyre. 48% e studentëve shpenzojnë 10 deri në 20 euro në muaj për të udhëtuar jashtë Tiranës, 39.2% shprehen se shpenzojnë 30 euro në muaj, ndërsa 12.8% nuk shpenzojnë para për udhëtime jashtë Tiranës, për shkak se i përkasin kategorisë që banojnë në banesat e familjeve në kryeqytet.



6. LITERATURA DHE MJETET STUDIMIT


Literatura dhe mjetet mësimore gjithashtu zenë një peshë të konsiderueshme në shpenzimet mujore të studentëve. 57.7% e tyre pohojnë se shpenzojnë 10 deri në 20 euro në muaj për mjetet mësimore, 18.5% shprehen se shpenzojnë 20 deri në 50 euro në muaj ndërsa 4.3% deklarojnë se shpenzimet për mjete mësimore e kalojnë shifrën 50 euro në muaj. 19.5% e studentëve pohojnë se shpenzojnë deri në 10Euro për mjete mësimore.



Ndërkohë që 45.2% e studentëve thonë se shpenzojnë nga 5 deri në 10 euro në muaj për literaturën, 22.3% shprehen se shpenzojnë 15 euro në muaj ndërsa 32.5% e studentëve pohojnë se literatura ju kushton 20 euro ose më shumë në një muaj.

7. VESHJE DHE ARGËTIMI

Për shkak të moshës së tyre, studentët përvec akomodimit, transportit dhe ushqimit kanë edhe nevoja të tjera si për t'u veshur argëtuar, për të shkur në kinema apo teatër dhe për kaluar kohën me miqtë e tyre. Një peshë specifike në buxhetin mujor të studentëve duket se zë edhe vlerja e rrobave. 42.7% e studentëve thonë se kostot mujore të blerjes së rrobave shkojnë nga 20 në 50 euro. 20.7% e studentëve thonë se shpenzojnë 100 euro ose më shumë për rroba, ndërsa. 16.3% e studentëve nuk shpenzojnë para për tëblerë rroba.




Ndërkohë sa i përket argëtimit, 32.5% e studentëve shpenzojnë nga 10 deri në 20 euro në muaj, ose më pak se 1 euro në ditë, 36.9% e tyre shprehen se shpenzojnë nga 20 deri në 50 euro për argëtim, ndërsa 20.1% e studentëve të pyetur thonë se shpenzojnë 100 euro ose më shumë për argëtim. 10.5% e studentëve kanë deklaruar se nuk shpenzojnë para për tu argëtuar.

8. TË ARDHURAT E STUDENTËVE

Sfidën kryesore për të përballuar shpenzimet e tyre studentët e kanë tek burimi i të ardhurave të nevojshme që ju duhen për të përballuar jetesën në kryeqytet. Më shumë se gjysmës së studentëve 53.8% të ardhurat mujore ja mbulon 100% familja e tyre, 38.7% të ardhurat i sigurojnë pjesërisht nga familja dhe nga bursa ose punësimi i tyre, ndërsa vetëm 7.5% e studentëve arrijnë ti mbulojnë të ardhurat mujore vetëm nga puna e tyre.


Qëndresa Qytetare e thelloi pyetësin për të kuptuar më shumë edhe mbi të ardhurat e familjeve të studentëve. 46.3% e studentëve u shprehën se të ardhurat totale të familjes së tyre variojnë nga 300 në 500 euro, 27.4% e tyre pohojnë se të ardhurat e familjes së tyre variojnë nga 500 në 700 euro dhe pjesa tjetër, 26.3% deklarojnë të ardhura mujore mbi 700 euro për familjen e tyre.

Shumica e studentëve, rreth 57.7% mendojnë se rroga mesatare e një studenti që punon ndërkohë që ndjek studimet është 200 euro, 24.6% mendojnë se rroga e një studenti shkon 300 euro, ndërsa 13.2% shprehen se një student paguhet 100 euro në muaj në Tiranë. Vetëm një pakicë prej 4.5% mendojnë se rroga e një studenti në Tiranë është më e lartë se 300 euro.



9. SHPENZIMET MESATARE PËR 1 STUDENT

Ekipi i Qëndresës Qytetare përlogariti koston mesatare që i duhet një studenti për të studiuar në kryeqytet. Për të nxjerrë koston mesatare të një student në kryeqytet u morën në konsideratë shpenzimet e 775 studentëve të anketuar mbi nevojat e tyre bazike si akomodimi apo ushqimi. Në këtë përlogaritje nuk janë marrë parasysh tarifat e studimit, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme në protofolin e çdo studenti. Sipas përlogartijes rezultoi se një student i duhet mesatarisht 324 euro në muaj për të përballuara jetesën në kryeqytet. Kjo është një shifër e lartë nëse do të krahasohet me të ardhurat që kanë deklaruar studentët për familjet e tyre ku 46.3% thonë se të ardhurat familjare të tyre shkojnë nga 300 në 500 euro.



10. GJETJET KRYESORE

- Drejtoritë e Konvikteve në Tiranë akomodojnë vetëm 7% të totalit të studentëve që studiojnë në kryeqytet. Nga 78 500 studentë, vetëm 5549 prej tyre mund të sigurojnë një shtrat në konvikt.
- Sipas përlogaritjeve të ekipit të Qëndresës Qytetare, një studenti që vjen nga rrethet për të studiuar në kryeqytet, mesatarisht i duhen 324 euro për të përballuar jetesën e tij, pa përfshirë kostot e tarifës së studimit.
- Rreth 55% e studentëve të pyetur shpenzojnë 50 deri në 150 euro për akomodim dhe 90 deri në 210 euro për t'u ushqyer në muaj.
- Rreth 70% e studentëve shpenzojnë 10 deri në 20 euro në muaj për të udhëtuar jashtë Tiranë dhe po kaq edhe për transportin brenda për transportin urban.
- 45.2% e studentëve shprehen se shpenzojnë nga 6 deri në 16 euro në muaj për literaturën, dhe 57.7% e tyre pohojnë se shpenzojnë 10 deri në 20 euro në muaj për mjetet mësimore.
- Shumica e studentëve, 63.4% e tyre shpenzojnë 10 deri në 50 euro në muaj për veshmbathje dhe 69.4% thonë se shpenzojnë 10 deri në 50 euro në muaj për argëtim. Ndërkohë që 16.3% e studentëve shprehen se shpenzojnë 0 lek për veshmbathje dhe 10.5% e tyre deklarojnë se shpenzojnë 0 lek për argëtim.
- Më shumë se gjysmës së studentëve 53.8% të ardhurat mujore ja mbulon 100% familja e tyre, 38.7% të ardhurat i sigurojnë pjesërisht nga familja dhe nga bursa ose punësimi i tyre, ndërsa vetëm 7.5% e studentëve arrijnë ti mbulojnë të ardhurat mujore vetëm nga puna e tyre.
- 46.3% e studentëve u shprehën se të ardhurat totale të familjes së tyre variojnë nga 300 në 500 euro, 27.4% e tyre pohojnë se të ardhurat e familjes së tyre variojnë nga 500 në 700 euro dhe pjesa tjetër, 26.3% deklarojnë të ardhura mujore mbi 700 euro për familjen e tyre.

11. REKOMANDIME

- Planifikimi dhe rritja e kapaciteteve akomoduese në kryeqytet për të mbuluar të paktën 50% e totalit të studentëve që vijnë nga rrethet dhe studiojnë në kryeqytet.
- Rritja e transparencës ndaj publikut dhe studentëve lidhur me ndërtimin e kampuseve universitare të planifikuara dhe premtuara në fushatën zgjedhore të 25 prillit, përfshi edhe mbështetjen e Bankës Gjermane për Zhvillim (KFË).
- Këshilli i Ministrave duhet të miratojë VKM-në për përcaktimin e skemës së Kreditimit Studentor, në zbatim të nenit 114 të ligjit për Arsimin e Lartë, me qëllim mundësimin e kredisë studentore si mjet për të ndihmuar financiarisht studentët.
- Fuqizimi, buxhetimi dhe kombëtarizimi i Kartës së Studentit si një mjet që i shërben studentëve për të reduktuar pagesat e shërbimeve dhe produkteve bazë.
- Rritja e masës së bursës ndaj studentëve me nevoja të vecanta dhe studentëve ekselentë, në masën e shumës që mundëson një jetesë normale studentore në kryeqytet dhe qytetet universitare.

